# DËSHMI ARKIVI

**A-450149**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjykata e Hagës: 303 të ndaluar u torturuan me varje, rrahje dhe mjete metalike |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/gjykata-e-hages-303-te-ndaluar-u-torturuan-me-varje-rrahje-dhe-mjete-metalike/1014875/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 17:54:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 17:54:15 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `398077b7265090f4a1a57ac71865360d287fa5f7650ce630951bd3988e21beff` |
| TEKSTI | `b8eca9ea8db1df733e0b6c628497680aefb0dfe8a178e8618e865b17f7927d6c` |
| PAMJA | `99c235dbc18ca3da6d5e519afa986f835de1fc78aa39fca476b56013c43668e1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0a76c7b296b51feabeb1421cf6d2bdbdddb8ae1959519882f1c58fd845f6c819` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0a76c7b296b51feabeb1421cf6d2bdbdddb8ae1959519882f1c58fd845f6c819`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gjykata e Hagës: 303 të ndaluar u torturuan me varje, rrahje dhe mjete metalike



Varja me kokë poshtë, përleshjet e detyruara mes të burgosurve dhe rrahjet deri në humbjen e vetëdijes ishin ndër format e torturës të konstatuara nga Trupi Gjykues.

Në përmbledhjen e aktgjykimit, Trupi Gjykues në Hagë paraqiti mënyrën se si ishin torturuar dhe trajtuar mizorisht personat e mbajtur në vende ndalimi nën kontrollin e pjesëtarëve të UÇK-së.

Sipas dokumentit, 348 persona u trajtuan mizorisht dhe 303 prej tyre iu nënshtruan torturës. Në kuptimin juridik, Gjykata shqiptoi fajësi për torturimin e 303 personave, si dhe, veçmas, për trajtimin mizor të 49 personave.

Personat e ndaluar mbaheshin në ish-shkolla, bodrume, stalla dhe objekte të tjera që nuk ofronin kushte të përshtatshme. Në shumë raste, hapësirat ishin tepër të ngushta krahasuar me numrin e njerëzve të vendosur në to.

Një pjesë e madhe e tyre detyroheshin të flinin mbi dysheme betoni, kurse disa qëndronin në baltë apo mes jashtëqitjeve njerëzore dhe shtazore. Në disa prej vendeve të ndalimit, ushqimi mungonte për ditë të tëra, ndërsa nuk siguroheshin as ujë, trajtim mjekësor dhe kushte minimale higjienike.

Gjykata vërtetoi se të ndaluarit goditeshin në mënyrë të përsëritur me kondakë pushkësh, shkopinj, hunj druri, bishta sëpatash, shufra metalike dhe kabllo elektrike.

Disa prej tyre lidheshin nga këmbët dhe liheshin të varur me kokën poshtë përpara se të rriheshin. Persona të tjerë detyroheshin të përlesheshin me njëri-tjetrin.

Goditjet vazhdonin deri në atë pikë sa viktimat nuk arrinin më të qëndronin në këmbë, mezi merrnin frymë ose humbnin ndjenjat. Plagët e marra gjatë këtyre rrahjeve u shkaktuan vdekjen disa personave.

Disa viktimave u shkuleshin thonjtë, ndërsa të tjera pësuan fraktura në duar, këmbë, kyçe dhe brinjë. Kishte

të fundit/


Protesta para Qeverisë vijon e qetë


Gjykata e Hagës: 303 të ndaluar u torturuan me varje, rrahje dhe...


VIDEO/ Goditje spektakolare nga mesi i fushës, 23-vjeçari i...


Nasim Haradinaj kërkon mbledhjen e Kuvendit të Kosovës...


Kadrijaj në protestë: Specialja dha vendim politik, lufta e UÇK-së...


Kandiq dallon vendimin ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së nga dënimet ...


Berisha nga Kuvendi i PD-së në Krujë: Protesta e ka kthyer...

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

gjithashtu persona që humbën dhëmbët ose që mbetën me shenja të përhershme.

Përveç dhunës fizike, Trupi Gjykues konstatoi se ishte ushtruar edhe torturë psikologjike. Të ndaluarit detyroheshin të dëgjonin britmat e atyre që rriheshin, përballeshin me simulime ekzekutimi dhe kërcënoheshin me vdekje.

Në raste të caktuara, ata u detyruan të varrosnin trupat e të ndaluarve të tjerë. Në një rast, trupi i një personi që kishte kryer vetëvrasje u la i varur brenda dhomës, në mënyrë që të shihej nga personat e tjerë të ndaluar.

Sipas përfundimeve të Gjykatës, këto veprime synonin nxjerrjen e informacioneve ose rrëfimeve, si dhe ndëshkimin, frikësimin, detyrimin apo diskriminimin e viktimave mbi baza politike dhe etnike.

Vendimi është dhënë në shkallën e parë dhe ndaj tij mund të paraqitet ankesë. Të dhënat janë pjesë e përmbledhjes zyrtare.

Shtuar më 16.09.2026 19:54

Tags: bishta sëpatash , kabllo elektrike , Rriheshin me kondakë , shkopinj dhe hunj druri , shufra metalike


Protesta para Qeverisë vijon e qetë


Nasim Haradinaj kërkon mbledhjen e Kuvendit të Kosovës pas vendimit…


Kadrijaj në protestë: Specialja dha vendim politik, lufta e UÇK-së ish…



Kandiq dallon vendimin ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së nga dënimet e zyrtarë…


Aktgjykimi në Hagë: Kundërshtarët e UÇK-së mbaheshin të prangosur…


Franca rikonfirmon mbështetjen për Kosovën dhe Dhomat e…



KFOR-i: Lëvizja e autokolonës ushtarake serbe pranë kufirit ishte…


Konjufca: Dënimi i ish-drejtuesve të UÇK-së është pritur me zhgënjim të ma…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.